



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 3649/prot.

Pogradec më, 22.09.2026

LËNDA: Njoftim për mbledhjen e Këshillit të Bashkisë Pogradec

Të nderuar!

Ju njoftojmë se ditën e Hënë , më datë 28.09.2026, ora 12:00, në sallën e mbledhjeve të Këshillit të Bashkisë Pogradec, zhvillohet mbledhja e rradhës e Këshillit të Bashkisë, e thirrur nga Kryetarja e Këshillit në bazë të ligjit 139/2015, neni 53 pika 4, dhe Regullores së Këshillit Bashkiak nr.40, datë 05.03.2020 me këtë rend dite :

1. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Rendit të ditës.
2. **Projekt – Vendim:** Miratimi i Procesverbalit të datës 24.08.2026.
3. **Projekt – Vendim:** Deklarimi I konfliktit të interesit nga këshilltarët, për vendimarrjen lidhur me çështjet e rendit të ditës
4. **Projekt – Vendim:** Leximi I vendimeve dhe konfirmimet e prefektit për mbledhjen e datës 24.08.2026
5. **Projekt – Vendim:** Për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi 6% e fondit të kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike, për muajin Gusht 2026.
6. **Projekt – Vendim:** Miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2027-2029 të Bashkisë Pogradec (faza II)
7. **Projekt – Vendim:** Për një shtesë në VKB Nr 128 dt 22.12.2025, “Miratimin dhe detajimin e Bashkisë Pogradec për vitin 2026”
8. **Projekt – Vendim:** Për miratimin për vazhdimin e strehimit të përkohshëm së znj. Elvira Rovi në banesën Sociale në pronësi të Bashkisë Pogradec , sipas vendimit të Këshillit Bashkiak Nr 94 datë 25.09.2025.
9. **Projekt – Vendim:** Për miratimin e procesit të Privatizimit të banesës në pronësi të Bashkisë Pogradec, në favor të familjes së z. Muhamet Ferit Golemi, e cila ka mbetur e pa privatizuar.
10. **Projekt – Vendim:** Për dhënie ndihme financiare për z. “Edmond Kuqo”.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADec
KËSHILLI

- 11.**Projekt – Vendim:**Miratimin në parim të marrjes me qira sipërfaqe toke/ truall + ndërtesë , për qëllime magazinimi dhe shërbimi, për nevoja të ndërrmarrjes së parqeve dhe rekreacionit pranë Bashkisë Pogradec.
- 12.**Projekt – Vendim:**Për miratimin në parim të dhënies me qira, në favor të individëve kërkues për ndërtim fotoboltaikë (stacionet, bazamentet dhe objektet përkatëse etj), të pasurisë me sipërfaqe totale 144000 m2 (Njëqind e dyzet e katër mijë) m2.
- 13.**Projekt – Vendim:** “Për miratimin e listës të sipërfaqes së tokës prej 8 5543 Ha , e ndodhur në Njësinë Administrative Cërravë që mund te jepen me qira”.
- 14.**Projekt – Vendim:**Për miratimin e Planit Vendor të Menaxhimit të Integruar të mbetjeve në Tetor 2026- Tetor 2031 për Bashkinë Pogradec.
15. Raportim nga Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore për periudhën 8 mujore dhe menaxhimin e sezonit veror .

KRYETARE E KËSHILLIT
MANJOLA KAMOLLI

Shënim: Mbledhjet e Komisioneve të Këshillit janë si më poshtë:

Komisioni I Financave, Buxhetit, Pasurive Bashkiake, Planifikimit të Zhvillimit Strategjik të Bashkisë,Mbikëqyrjes Financiare,I Ekonomisë Vendore, Turizmit dhe Zhvillimit Rural,

Komisioni I Mandateve, Rregulloreve, Ceshtjeve Juridike, Qeverisjes së Mire, Administratës,Zgjedhjeve, Strukturave Komunitare, I Etikës, Konfliktit të Interesit, Standarteve dhe Apelineve,, **Komisioni** I Shërbimeve Publike, Transportit, Levizshmërisë Mjedisore, Parqeve dhe Rekreacionit, Parkingjeve, I Zhvillimit Hapësinor, Infrastrukturas dhe Strehimit

Komisioni I Shëndetësisë, Veterinarisë, Mjedisit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, I Bujqësisë, Pyjeve, Menaxhimit të ujërave, Mbrojtjes së Mjedisit dhe Biodiversitetit, ditën e Premte , dt 25.09 .2026, ora 12:00 për pikat 1,2,3,4,5,6, 7,8,9,10,11,12,13,14,15, të rendit të ditës,në Sallën e Këshillit Bashkiak.